



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të zbardhura, ardhur së fundmi për mbledhjet e komisionit të datave 2 shkurt dhe 12, 13, 19, 26 dhe 27 prill.

2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shpalljen e moratoriumit të gjetisë në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Benet Beci dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Alfred Rushaj, Agron Shehaj, Erion Braçe, Alban Xhelili dhe Bujar Leskaj.

Të ftuar:

Almira Xhembulla – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit.

Klodiana Marika – Drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit Mjedisit.

Gentian Opre – Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen, verifikojmë kuorumin, i cili ekziston. Kështu që mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje.

Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbaleve të zbardhura, të ardhura së fundi, për mbledhjet e komisionit të datave 2 shkurt dhe respektivisht 12, 13, 19, 26 dhe 27 prill.

Miratojmë procesverbalet, atëherë, nëse nuk ka ndonjë vërejtje.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, për të cilin relatore është zonja Antoneta Dhima.

Të ftuar kemi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, zonjat Almira Xhembulla, zëvendësministre, dhe Klodiana Marika, drejtoreshë në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, të cilave u uroj mirëseardhjen!

Gjithashtu, kemi edhe zotin Gentian Opre nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Atëherë, po ia jap fjalën fillimisht zëvendësministres për të prezantuar projektligjin, për të vijuar më pas me relatoren përpara se të kalojmë te pyetjet dhe në vijim me diskutimet.

Fjala për ju, zonja zëvendësministre.

Almira Xhembulla – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i komisionit!

Të nderuar anëtarë deputetë,

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit paraqet sot për shqyrtim projektligjin “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektakti është të ndalojë ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë në të gjithë territorin e vendit, në mënyrë që të vijojë përmirësimi i llojeve të faunës së egër, objekt ose jo gjuetie.

Projektligji ka si objektiv kryesor që nëpërmjet këtij akti të arrihet krijimi i qetësisë së nevojshme dhe i kushteve të favorshme për rimëkëmbjen e faunës së egër, objekt gjuetie ose jo, dhe të reduktohet aktiviteti i paligjshëm që lidhet me këtë aspekt.

Projektligji është në linjë me kërkesat e programit të qeverisë, sepse e konsideron mbrojtjen e mjedisit, patjetër, si një nga detyrat më të rëndësishme dhe të përbashkët për të gjithë qytetarët.

Përpara këtij projektligji, ashtu siç edhe ju e keni informacionin, janë zbatuar edhe dy ligje të tjera për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë, respektivisht ligji nr. 7 i vitit 2014 dhe ai nr. 61 i vitit 2016.

Zbatimi i këtyre politikave dhe këtyre dy moratoriumeve ka krijuar premisa për një qetësi të nevojshme për rimëkëmbjen e popullatave të faunës së egër, objekt gjuetie ose jo, dhe rikthimin e një numri shpendësh shtegtarë falë qetësisë së vendosur, dëshmuar kjo edhe nga OJF-të mjedisore, punonjësit e administratave rajonale të zonave të mbrojtura, inspektorë mjedisi dhe ekspertë të ndryshëm të sektorit.

Mund të themi përmbledhtazi se zbatimi i moratoriumit dhe ndalimi i gjuetisë për një periudhë 7-vjeçare ka realizuar një rikthim dhe një përmirësim të situatës për faunën e egër në vendin tonë.

Nëse do të më lejoni, vetëm nga të dhënat që ne kemi nga Censi Ndërkombëtar i Shpendëve, që është realizuar në Shqipëri që nga viti 2016, ku në atë kohë u evidentuan 98 mijë shpendë, studim i kryer në 16 ligatina, vijmë në vitin 2022 ku janë evidentuar dhe vrojtuar 140 mijë shpendë në 29 ligatina.

Të dhënat e tjera i keni të detajuara, në dijeninë time, në një raport që ju është dërguar paraprakisht nga ministria.

Megjithatë, duhet ta pranojmë se gjatë kësaj periudhe ka pasur raste edhe të ushtrimit të gjuetisë së paligjshme.

Gjatë periudhës së moratoriumit, nga njëra anë është konstatuar mbështetje nga drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit dhe të Inspektoratit, por sigurisht në nivel lokal janë evidentuar edhe raste të zbatimit jo aq me rigorozitet të ligjit, kjo si rrjedhojë e justifikuar ndoshta edhe nga mungesa e kapaciteteve dhe e infrastrukturës mbështetëse të inspektorëve në terren, mosfunksionimi siç duhet i organit të akuzës për rastet e ndaluara, si dhe të riorganizimit të vetë strukturave inspektuese në mënyrë të vazhdueshme.

Prandaj, pikërisht lidhur me këtë, në projektligj i është kushtuar kujdes dhe është bërë një përcaktim i qartë dhe i saktë i organeve kontrolluese, gjë e cila nuk ka qenë e shprehur në dy projektligjet e tjera, por thuhej vetëm: “ngarkohet ministri i Mjedisit, ministri i Brendshëm, ministri i Financave e me radhë për zbatimin e atij projektligji”.

Organet që do të monitorojnë rregullat për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë do të jenë kryesisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet institucioneve të varësisë brenda fushës së përgjegjësisë që mbulon, si dhe Ministria e Brendshme dhe strukturat përgjegjëse kontrolluese dhe inspektuese në bashki.

Ajo që dua të vlerësoj dhe të evidentoj është se ndaj shkeljeve dhe abuzimeve të lartpërmendura nga viti në vit është mbajtur qëndrim dhe është ndërhyrë nga organet ligjzbatuese.

Për shembull, nga të dhënat e Policisë Pyjore rezultojnë se në vitin 2014 janë ushtruar 350 inspektime gjatë të cilave janë proceduar për gjueti të paligjshme 30 persona, janë vendosur 1,6 milionë lekë gjoba, janë sekuestruar në Policinë e Shtetit rreth 630 armë gjahu dhe janë sekuestruar mjete e pajisje të ndaluara për gjuetinë e me radhë deri në vitet 2019, ku janë ushtruar 506 inspektime. Në vitin 2019, sipas të dhënave të administratave të zonave të mbrojtura në qarqe, janë konstatuar 12 raste të paligjshme. Në vitin 2020, sipas të dhënave që ne kemi nga administratat rajonale të zonave të mbrojtura, janë konstatuar 4 raste të gjuetisë së paligjshme.

Prandaj, duke pasur parasysh edhe numrin e këtyre rasteve të evidentuara, si ministri kemi menduar që ta zgjasim edhe për një 5-vjeçar tjetër moratoriumin e gjuetisë.

Efektet që priten nga zbatimi i këtij akti lidhen edhe me një numër përfitimesh, qoftë nga rikthimi dhe rimëkëmbja e popullatave të faunës së egër, te rikthimi i vlerave të natyrës dhe të diversitetit biologjik, por patjetër deri tek efektet ekonomike dhe financiare.

Përmbledhtazi, mund të themi se rritet biodiversiteti dhe sidomos numri i shpendëve të vrojtuar dhe të evidentuara, rritet numri i turistëve që lidhet me vizitorët, qofshin këta vrojtues të shpendëve, qofshin fotografë të botës së egër apo edhe dashamirës të natyrës. Mijëra qytetarë vendas dhe sidomos të huaj do të vizitojnë mjediset tona natyrore dhe do të sjellin një kontribut të ndjeshëm në ekonominë lokale, patjetër edhe në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë.

Tashmë kemi disa ture që janë të instaluar. Një numër i lartë turistësh dhe vizitorësh, që ne i kemi të evidentuar, frekuentojnë zonat e mbrojtura...

Nëse më lejoni, për shembull, nga të dhënat që kemi ne, nëse në vitin 2018 kishte 2467132 turistë që kanë vizituar zonat e mbrojtura, në vitin 2021 kemi rreth 4300000 vizitorë, qofshin këta të huaj apo vendas. Të gjitha parqet kombëtare, parqet natyrore, monumentet e natyrës dhe, sigurisht, kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e krijimit të një qetësie, përmirësimit dhe rritjes së numrit të shpendëve dhe të individëve të faunës së egër.

Meqenëse jemi para Komisionit të Ekonomisë, nëse më lejoni dhe nëse e shikoni të arsyeshme, dua të përmend se nga shifrat e lartpërmendura evidentohet një rritje e vizitorëve në zonat e mbrojtura me rreth 30% nga viti 2018 në vitin 2019. Edhe pse nuk mund ta themi me siguri, kjo shifër ndoshta nuk do të ishte e tillë nëse gjuetia do të ishte lejuar.

Për të konkluduar, duhet thënë se ka një interes të shtuar për të vizituar natyrën, pikërisht për shkak të kësaj qetësie të krijuar. Shtimi i turistëve patjetër që do të ketë efekte pozitive tek të ardhurat e bizneseve të ekoturizmit dhe për rrjedhojë të ardhura shtesë edhe për buxhetin e shtetit.

Lidhur me konsultimin publik, dua të shpreh se ky projektligj i ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publik. Konkretisht, është organizuar një takim në datën 13.07.2021, me pjesëmarrjen e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër, në të cilin nga njëri prej anëtarëve të këshillit është evidentuar se situata e faunës së egër u rrit në vitet e para, por pastaj mbeti e pandryshuar. Në këtë takim janë prezantuar edhe raste të shkeljes së moratoriumit.

Një takim tjetër për konsultimin e publikut u mbajt në datën 3.11.2021, ku, në fakt, në atë kohë ishte publikuar më parë edhe në faqen e ministrisë, por megjithëse numri i vizitorëve në këtë faqe ka qenë rreth 1351 vizitorë, nuk ka pasur komente të shkruara.

Pas këtij, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është mbajtur takimi i dytë i Këshillit Kombëtar të Faunës, ku anëtarë janë një sërë organizatash mjedisore, institucione të Policisë së Shtetit, agjencia e pushtetit vendor, por bëjnë pjesë edhe dy federatat e gjuetarëve. Gjatë këtij takimi konsultativ ne jemi përpjekur t'i dëgjojmë me vëmendje, të diskutojmë me ta dhe përsëri nga ana e tyre ka ardhur mendimi se ndoshta moratoriumi do të ishte mirë të zgjatej vetëm një vit, kohë e nevojshme për të përmirësuar kuadrin ligjor të gjuetisë dhe performancën e strukturave menaxhuese.

Megjithatë, duhet të themi se nga ekspertët në Ministrinë e Mjedisit, duke pasur parasysh fokusin që ka jo vetëm ministria, por edhe qeveria shqiptare lidhur me mbrojtjen, konservimin, zhvillimin e zonave të mbrojtura dhe të mjedisit, ne kemi menduar që moratoriumi të zgjatet edhe për 5 vjet të tjerë, me qëllim që të organizohet puna, duke filluar brenda këtij viti për asistimin e punonjësve përkatës, veçanërisht nëpër bashki. Sepse ju e dini që pas reformës territoriale shumica e territoreve dhe pyjeve e kullotave administrohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë ngritur strukturat e tyre menaxhuese dhe kontrolluese për të gjithë territorin e pyjeve dhe kullotave. Patjetër, gjatë kësaj periudhe do të punohet, pasi është një proces tejet i rëndësishëm, që të bëhet inventari i faunës së egër, sepse vetëm në këtë mënyrë ne do të kemi të dhëna dhe, le të themi, data shumë të rëndësishme për sa i takon këtij procesi.

Para disa kohësh ne si ministri kemi prezantuar edhe inventarin e pyjeve, ndaj tani është shumë me rëndësi të bëjmë edhe inventarin e faunës së egër, pse jo, edhe inventarin e bimëve mjekësore shumë shpejt.

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë, të kushtetutshmërisë dhe harmonizimit të legjislacionit në fuqi...

(Deputeti Braçe flet pa mikrofon.)

...sikurse ju e dini, por ashtu siç edhe e përmenda, ky akt del si një kërkesë për të përmirësuar më tej kushtet për të bërë të mundur rimëkëmbjen dhe zhvillimin normal të popullatave të faunës së egër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...objekt gjuetie dhe do të shërbejë për përmbushjen e detyrimeve që kemi ne ndaj konventave në fushën e mbrojtjes së natyrës, ku Shqipëria është palë.

Gjithashtu, projektligji do të kontribuojë në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe specifikisht objektivit nr. 15, synimit 15:15, që kërkon pikërisht të ndërmerren veprime urgjente dhe domethënëse për të reduktuar degradimin e habitateve natyrore për të ndaluar humbjen e biodiversitetit dhe për të mbrojtur e parandaluar zhdukjen e specieve të kërcënuara.

Projektligji nuk synon transpozimin e *Acquis Communautaire* dhe nuk ka efekte në buxhetin e shtetit. Ndërsa lidhur me detajimin dhe çështjet kryesore që parashikon, ka të bëjë pikërisht me përcaktimin e organeve kontrolluese dhe monitoruese...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rastet përjashtimore lidhen me rastet kur duhet të bëjmë studime shkencore dhe një tjetër është parashikuar kur kemi raste të evidentimit të mbipopullimit të faunës së egër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tre organet kontrolluese janë të përcaktuara në nen, përveç kohëzgjatjes që lidhet me periudhën 5-vjeçare.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Fjalën e ka zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre për prezantimin e projektligjit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Ky projektligj është i mbështetur në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që ka Shqipëria në kuadër të konventave të fushës së mbrojtjes së natyrës, ku është palë.

Projektligji i ri vjen pas një periudhe 7-vjeçare nga zbatimi i dy memorandumeve të mëparshme për ndalimin e gjuetisë, periudhë kjo e cila ka realizuar një rikthim dhe përmirësim të situatës për faunën e egër në vendin tonë.

Ka pasur dy ligje të mëparshme, ai i vitit 2014 dhe i vitit 2016, si dhe një tjetër ligj për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në vitet 2016-2021, të cilit i mbaroi afati vitin e kaluar.

Me projektligjin e ri moratoriumi i gjuetisë do të vijojë edhe për 5 vjet të tjera, duke vënë në dukje se ka pasur rezultate domethënëse ndalimi i gjuetisë në këto vite. Janë konstatuar të gjitha efektet pozitive të masave të marra në dy moratoriumet e mëparshme në lidhje me faunën e egër, sidomos për shpendët e egra.

Në censin e zhvilluar në vitin 2016 është konstatuar një rritje e ndjeshme e llojit të shpendëve të egër dhe faunës së egër, si dhe një ndërgjegjësim i popullatës, falë një komunikimi të shtuar me ambientalistë dhe shoqatat e ndryshme të faunës dhe të mjedisit.

Referuar censit të zhvilluar në vitin 2016, janë konstatuar rreth 60 mijë shpendë të egra në habitatin e ekosistemit shqiptar, ndërsa në vitin 2021 ishin rreth 140 mijë individë të tillë. Ky cens bëhet zakonisht çdo vit në të njëjtën periudhë nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Gjithashtu, ka një efekt të rëndësishëm shpallja e këtij moratoriumi, sepse kufizon ndjeshëm shpërndarjen dhe kërkesën për t'u pajisur me leje armësh gjahu. Në dy vjetët e parë, falë këtij moratoriumi janë sekuestruar mbi 800 mijë armë gjahu. Në vitet 2015-2016 kemi një ndalesë totale të aktivitetit gjuetar edhe nga gjuetarë të huaj, të cilët në kohën kur nuk ka qenë moratorium, vinin në mënyrë të shpeshtë për të gjuajtur, por përdornin edhe mjete të paligjshme për gjueti.

Megjithatë, nuk mund të pretendojmë se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të ushtrimit të gjuetisë, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin “Për moratoriumin e gjuetisë”. Edhe pse ndalimi i gjuetisë ka dhënë rezultate në përmirësimin e situatës së faunës së egër, gjatë kësaj periudhe në shumë vende ka aktivitet i cili është zhvilluar në mënyrë të paligjshme.

Në relacionin shoqërues të projektligjit citohet se “Aktiviteti i paligjshëm ka vazhduar si rezultat i mungesës së kapaciteteve, i infrastrukturës, bashkëpunimit joproduktiv në terren”, shkaqe këto të cilat kanë bërë që vitet e fundit të ketë një rritje të rasteve të gjuetisë së paligjshme.

Referuar projektligjit të ri për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë, krahas afatit të zgjatjes për pesë vjet deri në vitin 2027, drafti nuk ka përcaktuar rritje të gjobave për

shkelësit, të cilët mbeten në 800 mijë deri në 1 milion lekë për shoqatat e gjuetarëve dhe 80 mijë deri në 100 mijë për individët.

Gjuetia do të lejohet vetëm në rastet kur konstatohet mbipopullim i specieve të caktuara në zonat e lejuara për gjueti.

Zgjatja e periudhës së moratoriumit edhe për pesë vjet, e parashikuar në këtë projektligj, do të ndihmojë rimëkëmbjen e popullatave në të gjitha llojet e shpendëve dhe do të jepte mundësinë e një pasurimi të ndjeshëm të biodiversitetit në Shqipëri.

Rritja e tij dhe sidomos e efektivave të shpendëve do të sjellë padyshim edhe një shtim të plotë të turizmit, gjë e cila u theksua edhe në fjalën e zëvendësministres, në lidhje si me vizitorët, ashtu edhe me vrojtuesit e shpendëve.

Kujtoj se katër vjet më parë Federata Kombëtare e Gjuetisë propozoi që gjuetia të kthehet në një sport të licencuar kundrejt pagesës, që mund të sillte deri në 12 milionë euro të ardhura në vit për buxhetin, por nga ministria përkatëse u vlerësua serikthimi i faunës së egër dhe tërheqja e tureve të vëzhgimit të shpendëve ofrojnë një imazh më të mirë dhe një përfitim më të madh për vendin.

Shqipëria ka marrë pjesë dy herë në panairët ndërkombëtare të turizmit natyror dhe vëzhgimit të zogjve. Gjatë panairit vizitorëve iu prezantuan zonat e mbrojtura të Shqipërisë dhe veçoritë specifike të tyre. Vizitorët italianë, qytetarë të thjeshtë, por edhe ekspertë të kësaj fushe të turizmit natyror, biologë dhe fotografë të natyrës, shprehen shumë interes për të vizituar Shqipërinë, një vend ende i panjohur për sa u përket vlerave natyrore që ai mbart.

Sikundër jemi njohur të gjithë me relacionin, ky projektligj i është nënshtruar një procesi të gjatë konsultimi, siç e theksoi edhe zëvendësministrja në fjalën e saj.

Konsultimi është zhvilluar dhe drejtuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër, ku është evidentuar situata e faunës së egër, e cila ka mbetur e pandryshuar gjatë periudhës së fundit, si dhe u prezantuan edhe raste të tjera të rritjes së gjuetisë së paligjshme dhe të vrasjeve të llojeve të ndryshme. Kjo gjendje u bë e njohur nga pjesëmarrës të ndryshëm, përfaqësues të Federatës së Gjuetarëve apo edhe organizatave jofitimprurëse.

Në zgjatjen e memorandumit të gjuetisë prevalon interesi për ruajtjen e faunës, për ruajtjen e mjedisit, si dhe për ruajtjen e zonave të mbrojtura. Ky projektligj nuk paraqet efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi implementimi i tij nuk do të kërkojë buxhet shtesë në interes të kësaj ministrie.

Prandaj, të nderuar kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj si komision për dhënie mendimi.

Nëse dikush nga kolegët ka interes për të bërë pyetje dhe diskutime të mëtejshme, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese është komisioni përgjegjës. Sot mund të ishte pjesë e kësaj dëgjese edhe Ministria e Brendshme, por në komisionin përgjegjës mund të sigurohet edhe pjesëmarrja e Ministrisë së Brendshme, e cila është një nga tri institucionet që do të ndjekë zbatimin e këtij projektligji.

Meqë e kam fjalën, zoti kryetar, mund të bëj një pyetje?

Eduard Shalsi - Patjetër.

Antoneta Dhima – Në nenin 6 të projektligjit janë përcaktuar organet që monitorojnë rregullat për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që janë kryesisht Ministria e Turizmit e Mjedisit nëpërmjet institucioneve të saj të varësisë, Ministria e Brendshme nëpërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë së Shtetit, si dhe strukturat inspektuese dhe kontrolluese brenda territorit të bashkive ku ushtrohet aktiviteti i gjuetisë.

Në pikën 3 të po këtij neni theksohet se të drejtën e vendosjes së gjobës e kanë strukturat e përcaktuara në pikën 1, të cilat sapo i citova. Ato kanë të drejtën e vendosjes së gjobave për bizneset në vlerën nga 800 000 -1 000 000 lekë, kurse për personat fizikë nga 80 000 - 100 000 lekë.

Cili nga këto institucione është kompetenti për vendosjen e gjobës, sepse mund të ketë përplasje midis institucioneve në vendosjen e gjobave?

Njëkohësisht, përcaktohet që ministria do të nxjerrë vendime për zbatimin e këtij projektligji. A i keni gati aktet, sepse moszbatimi siç duhet i memorandumit të mëparshëm ka sjellë për pasojë që institucionet nuk kanë koordinuar mirë me njëri-tjetrin dhe ka pasur probleme në territor?

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zonja Dhima!

Kemi hapur edhe siparin e pyetjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbarojmë shpejt se shumë pak pyetje ka.

Zonja Resulaj ka një pyetje.

Pranvera Resulaj - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, e nderuar zonja zëvendësministre!

Në fakt, unë lexova relacionin që shoqëron projektligjin, ju dëgjova ju, dëgjova relatoren dhe u bëra pak konfuze, ndaj do të doja ta përmbledh edhe një herë në pyetje.

Në relacionin që lexova thuhet se po kërkohet një zgjatje e moratoriumit për një periudhë 5-vjeçare për shkak se nuk ka funksionuar si duhet deri tani. Pra, kanë kaluar 7 vjet dhe tani kërkoni ta zgjasni afatin edhe me 5 vjet të tjera. Ne pretendojmë të mbrojmë mjedisin për 12 vjet, por ndërkohë në 7 vjet nuk e kemi arritur.

Në relacionin që shoqëron projektligjin thuhet se ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me policinë, por nuk kanë funksionuar siç duhet inspektoratet dhe kryesisht problemi ka qenë tek inspektorët, të cilët kanë pasur eficiencë të ulët. Pra, duket sikur faj i mospasjes ka qenë tek inspektorët. Çfarë më siguron mua sot se në 5 vjetët e ardhshme këta inspektorë do të bëhen eficientë, ndërkohë që nuk kanë qenë gjatë 7 vjetëve të kaluara?

Agjencia Kombëtare e Florës dhe Faunës së Egër (nuk e di si quhet saktësisht) ka deklaruar se gjendja ka mbetur e pandryshuar, ndërkohë këtu thuhet se ka pasur një përmirësim të gjendjes së mëparshme. Nuk jam shumë e qartë për këtë. Pra, ne po kërkojmë një shtyrje të moratoriumit, sepse gjendja nuk ka ndryshuar, është përkeqësuar dhe ka nevojë akoma për t'u mbrojtur ky mjedis, flora dhe fauna. Apo kjo ka një ndikim më të mirë në turizëm, sepse këtu u prek edhe koncepti i rritjes së numrit të vizitorëve në këto zona të mbrojtura? Nga ana tjetër, ne e dimë që turizmi i gjuetisë është një element që sjell të ardhura dhe numër vizitorësh.

Për sa u përket dëgjësive publike, ato më duken pak. Edhe numri 1351, në mos gaboj, i personave që kanë klikuar te faqja e konsultimit publik nuk më duket shumë i madh. Ndoshta do të duhet që informacioni të shtrihet pak më gjerë, sepse ky është një problem që e hasim gjithmonë. Duket sikur konsultimi publik bëhet pak i kufizuar dhe jo ashtu siç do të duhej për të pasur një gjithëpërfshirje më të madhe.

Pse po e kërkojmë saktësisht një shtyrje të moratoriumit?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Tani jemi te pjesa e pyetjeve.

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj - A do të ketë kosto shtesë në buxhetin e shtetit pas moratoriumit dhe si i keni llogaritur ju përfitimet që do të ketë biznesi në Shqipëri pasi të jetë vendosur moratoriumi?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Koliqi.

Emilja Koliqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju paraqitet sot një projektligj të ri, që është vazhdim i moratoriumit 7-vjeçar. Që në momentin kur është vendosur ligji i parë, në vitin 2014, ka pasur një kundërshtim nga shoqatat e gjuetarëve. Mbi 17 mijë gjuetarë në të gjithë vendin janë privuar prej 7 vjetësh nga e drejta për të ushtruar pasionin e tyre. Ata shprehen se sikur të zbatohen ligjet që ndalojnë gjuetinë e paligjshme, nuk do të kishte probleme në vend.

Megjithëse ka një moratorium 7-vjeçar, gjuetia e paligjshme vazhdon në të gjithë vendin.

Për shembull, në Liqenin e Shkodrës gati përnatë gjuhet peshk me gjenerator, por askush nuk ndërhy, as nga ana e policisë, as nga ana e Inspektoratit të Zonave të Mbrojtura. Janë vetë inspektorët e zonave të mbrojtura ose punonjësit e tyre, të cilët e ushtrojnë këtë gjueti të paligjshme. Rasti i vdekjes të një punonjësi të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Elbasan e dëshmon këtë gjë.

Përveç kësaj, ju vendosni edhe gjoba në shuma të mëdha, por unë nuk e kuptoj kujt i vendosen këto gjoba. Në qoftë se shoqatat e gjuetarëve kanë pasur një numër të konsiderueshëm anëtarësh, duke mos e ushtruar aktivitetin e tyre, sot ata janë pakësuar shumë dhe ka mbetur një bërthamë shumë e vogël. Kujt do t'i vendoset gjoba? Ju thoni se gjoba do t'u vendoset personave fizikë ose shoqatave të gjuetarëve, por të gjithë ata që ushtrojnë gjuetinë e paligjshme nuk janë anëtarë të shoqatave.

Për sa i përket konsultimit publik, ju thoni se e keni shpallur projektligjin në faqen *web* të institucionit dhe keni 1500 klikime. Anëtarët e shoqatave të gjuetarëve janë njerëz në moshë të madhe dhe nuk më duket se kanë aq akses në faqet *web*, aq më tepër të ministrive të ndryshme. Prandaj, klikimet janë shumë të pakta e aq më tepër nuk keni komente.

A janë zhvilluar konsultime publike me shoqatat?

Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë ka dorëzuar në parlament një petition me 21 mijë firma për ndryshimin e ligjit të gjuetisë dhe ndërprerjen e moratoriumit, por nuk ka marrë asnjëherë përgjigje. Ndoshta këtë pyetje duhet ta drejtoj edhe te kryetari i komisionit. Pse nuk u është dhënë asnjë përgjigje?

Në qoftë se kërkohen ndryshime ligjore në ligjin “Për gjuetinë”, për të cilat mund të kenë rënë dakord edhe shoqatat e gjuetarëve, dhe ato kanë kërkuar moratorium vetëm për 1 vit, kaq e vështirë është që ne t'i realizojmë ndryshimet ligjore që të mos ketë më gjueti të paligjshme brenda 1 viti, por na duhen 5 vjet?

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zonja Koliqi!

Kam edhe unë një pyetje, meqenëse jemi marrë që në kohën kur ky ligj është miratuar. Që moratoriumi për gjuetinë në një periudhë të caktuar ishte vendimi i duhur dhe që e kemi mbështetur, kjo nuk ka pasur asnjëllaj dyshimi. Është diskutuar për një sistem për mënyrën si armë hyjnë në Shqipëri, regjistrimin e tyre në dyqanet e shitjeve, licencimin nga Ministria e Brendshme, gjurmimin e tyre, por edhe për një projekt, që kam përshtypjen se u morr si eksperiencë nga Sllovenia, nga Franca, nga disa vende, ku gjuetarët do të pajiseshin me një bexh, që do të kishte edhe një çip. Në këtë mënyrë, aplikimet për të gjuajtur do të bëheshin nga telefoni dhe kështu do të ishte lehtësisht e verifikueshme gjurmueshmëria midis lejes që kishin kërkuar për të ushtruar gjuetinë dhe pozicionit apo vendndodhjes së tyre. Ka qenë një plan tejet ambicioz, që përmblihte eksperiencat më të mira të disa vendeve. A është zhvilluar një program i tillë?

Pra, thamë se benefitet e moratoriumit të gjuetisë janë të jashtëzakonshme, por edhe pjesa e paligjshme është reduktuar në masë shumë të madhe. Është moratorium dhe në një moment do të duhet të mbarojë.

Për sistemin që duhet të ndërtohet po punohet apo jo?

Pra, gjuetarët aplikojnë, merrnin lejen dhe policia e kishte shumë të lehtë të bënte verifikimin, sepse *Geographic Information System* i inkluduar te kartat e bexhit të lejonte në kohë reale të identifikojë ku gjendeshin. Nëse nuk është proceduar, është imediate që në momentin kur moratoriumi të përfundojë sistemi të jetë i gatshëm.

Siç e tha edhe zoti Sinaj, atëherë ne kemi pasur dëgjesa edhe me policinë. Ishte shumë e vështirë për policinë pasi kapte gjuetarë të paligjshëm. Merrte në telefon, ato duhet të futeshin në kompjuter, kishte rekorde, nuk kishte rekorde, kush ishin, si ishin, si nuk ishin, sepse i gjithë sistemi i gjurmueshmërisë linte shumë për të dëshiruar. Pra, sot ka ardhur momenti të ndërtohet një sistem i tillë.

Kjo ishte edhe pyetje, edhe sugjerim, në rast se nuk është bërë.

Tani fjalën e ka zoti Agalliu dhe pastaj ju për t'u përgjigjur.

Arbi Agalliu - Për të mos shpenzuar kohë, unë kam një pyetje dhe në fund do të bëj një diskutim. Ku e dalloni atë që gjuan nëse është subjekt apo individ, sepse gjoba ishte ndryshe për subjektin dhe ndryshe për individin? Unë nuk besoj se ai që është subjekt del me NIPT të varur në qafë apo pa NIPT ai që është individ.

Për mendimin tim, pjesa e moratoriumit është kot, sepse hyn në vazhden e atyre vendimeve apo ligjeve që jo që nuk zbatohen, por vetë ju nuk keni asnjëllaj përgjegjshmërie që këto të zbatohen.

Pse e them këtë? Po jap një shembull konkret. Para pak ditësh në një emision investigativ u denoncua rasti i gjuetisë. Ligji përkatës thotë se një peshkatar, i cili peshkon për qejfin e tij, nuk mund të ketë më shumë se 3 kallama dhe nuk mund të peshkojë më shumë se 5 kilogramë peshk. Në mes të qytetit të Durrësit kanë denoncuar një individ me 4 kallama dhe me më shumë se 5 kilogramë peshk. Është marrë në telefon që nga ministria, zëvendësministri, drejtori i Policisë, zjarrfikësja, çdo institucion shtetëror, por nuk lëvizi njeri. Edhe në këtë rast të jeni të bindur që do të ndodhë sikurse ka ndodhur, sepse ai që zbaton ligjin, e zbaton dhe kur gjuetia lejohet sipas ligjit.

Ju thatë se në vitin që lamë pas, vitin 2021, janë sekuestruar 630 armë gjahu, që, për mendimin tim, janë shumë në një vend si Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

Janë shumë armë pa leje, thashë.

Keni 7 vjet që e keni ndaluar gjuetinë dhe tani doni ta ndaloni edhe për 5 vjet të tjera. Është jashtë çdo sensi logjik t'u mohosh atyre që e kanë, qoftë edhe pasion, në një vend demokratik, këtë të drejtë për mbi një dekadë. Unë jam shumë dakord që moratoriumi të vendoset në momente të caktuara kur kemi një emergjencë kombëtare dhe bën sens 1 vit, 2 vjet, 3 vjet, 4 vjet apo 5 vjet, por jo 12 vjet. Është tmerr. Nuk ka lidhje. Nuk bën sens. Është jashtë çdo logjike normale, sepse në këto 12 vjet nuk keni bërë asgjë. Nëse ju do të kujdeseshit për mjedisin, nuk do të lejonit ndërtimin e aeroportit të Vlorës, që është një masakër. Ndërkohë më thua këtu se kanë ardhur fotografët të fotografojnë dhe se është rritur numri i shpendëve. Si flet ti për këtë, kur për aeroportin e Vlorës nuk ke thënë gjysmë fjale, ku atje ka filluar ndërtimi dhe ju nuk keni dhënë asnjë leje për atë gjë? Nuk keni dhënë. Po jua bëj pyetje të drejtpërdrejta: keni dhënë leje mjedisore për ndërtimin e aeroportit të Vlorës? Po apo jo? Nuk po hyj më tej, ku ekspertët thonë që është rrezik për mjetet motorike fluturuese, për avionët, helikopterët dhe ku e di unë çfarë, ndërtimi i aeroportit në atë zonë, sepse ka shpendë të përmasave të mëdha. Pra, ju nuk doni t'ia dini për shpendët, për zogjtë, fare, doni t'ia dini për interesa të caktuara. Nuk mund të thuash që ju, si ministri, kujdeseni për mjedisin. Doni të kujdeseni për mjedisin: ndaloni ndërtimet në Tiranë, ndaloni kullat që ndërtohen, të cilat e ndotin mjedisin përditë. Vendos moratorium për ndërtimin, sepse kemi dhjetëra e dhjetëra herë më shumë ndërtime sesa nevojë. Po atë s'e ndaloni dot, se aty ka pastrim parash, ka interesa, ku ndërtohen kulla në mes të liqenit e kështu me radhë.

Tjetra, nuk mund të mendojmë se 5 vjet të tjera do të bëjnë ndryshim rrënjësor në këtë sektor, kur kanë kaluar 7 vjet. Nëse në këto 7 vjet ne kemi pasur një përmirësim, hajde ta

vendosim gjuetinë sipas rregullit dhe standardit. Këtu ne shikojmë, dëgjojmë dhe lexojmë raporte ku korrupsioni, po marr shembull nga administrata tatimore, është evident, madje ka subjekte që punojnë pa paguar tatime, jo më një person që gjuan atje gjahun në mes të pyllit, ku nuk ka as kamera, ku nuk ka as individë të tjerë, të ta shikojnë.

Pra, e nderuar, personalisht jam për zbatimin e ligjit. Patjetër mund të kufizohen zona të caktuara në të cilat mund të ketë shpendë në zhdukje, mund të ketë gjallesa të tjera që janë të mbrojtura apo që janë drejt zhdukjes, por të ndalohet me këtë pretekst, nuk është e drejtë. Nëse doni të mbroni mjedisin, ndaloni aty ku abuzohet me mjedisin, duke filluar nga kullat këtu përballë deri në Vermosh apo Konispol, ku po ndërtohen në bregdetin jonian, resorte dhe s'pyet njeri për mjedisin, madje edhe pa leje, meqenëse keni vendosur edhe IKMT-në për të ruajtur zogjtë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Era e opozitarizmit po ndihet me kryetarin, por kaluam tani nga ndërtimet po flasim për...

(Deputeti Arbri Agalliu flet pa mikrofon.)

Dakord!

Edhe unë mendimi tim po them, por nëse gjithsecili do të merrte kazusin e vet...

Një sekondë, e ka kërkuar fjalën zonja Koti. E morët fjalën një herë zoti Sinaj, do ta merrni për diskutim?

Tani, do t'i japim mundësi zëvendësministres të përgjigjet dhe pastaj do të vijoni ju.

Po, zonja Koti.

Sorina Koti – Edhe unë në vazhdimësi të mendimit të kolegëve Agalliu dhe Koliqi, dua të theksoj pak faktin e mbrojtjes së mjedisit për zonën e Korçës, atje ku vazhdon të jetë ende shqetësim ndërtimi i TEC-it, pasi ju keni dhënë leje ndërtimi për TEC-in. Vërtet po flasim këtu për gjuetinë dhe Korça është një zonë ku zhvillohet gjueti, ka edhe Shoqatën e Gjuetarëve, të cilët më kanë dhënë edhe mendimin e tyre kundër moratoriumit të gjuetarëve dhe këtu po shpreh mendimin dhe vendimin e tyre.

Meqenëse jemi duke folur për mbrojtjen e mjedisit, dua të bëj disa pyetje. A është anuluar leja e ndërtimit të TEC-it? Si do të ndikonte kjo nëse ju do të vazhdonit përsëri me ndërtimin e tij? Çfarë ndikimi do të ketë ky ndërtim në mjedisin tonë, në faunën, në florën edhe në turizmin që ka Korça, të cilin e ka ngritur me shumë mund deri më sot? Korça nuk do të ishte më ai qyteti turistik me atë ambient të pastër me këto masa të marra nga ju. Unë i kam kërkuar edhe Ministrisë së Infrastrukturës të shohë vendimin e anulimit të TEC-it, por

nuk e ka marrë ende këtë vendim, ndoshta sot meqenëse u hap edhe tema e mjedisit për turizmin, do e bëni publike ju si ministri e mjedisit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, meqenëse konvergojnë disa nga pyetjet e kolegëve, ju lutem, t'i jepni përmbledhtazi përgjigjet.

Almira Xhembulla – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë, për larmishmërinë e pyetjeve!

Në fakt, dua ta falënderoj deputeten relatore për komentën që bëri lidhur me saktësimin për institucionet kontrolluese dhe ligjzbatuese, veçanërisht për vendosjen e gjobave që parashikohen në këtë projektligj.

Ashtu siç e shpjegova, në fakt, në fjalën time, në nenin 6, ndryshe nga dy moratoriumet e tjera, në këtë projektligj janë saktësuar 3 institucione Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, nëpërmjet institucionit të varësisë (këtu dua të sqaroj që janë inspektorët e Agjencisë së Mjedisit), Ministria e Brendshme dhe strukturat inspektuese, monitoruese dhe administruese nëpër bashki. Domethënë, këto tri struktura do të punojnë në varësi të kompetencave që kanë. Për shembull, territoret e zonave të mbrojtura, kryesisht janë nën administrimin e administratave rajonale të zonave të mbrojtura dhe ato janë struktura përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Në territoret që konsiderohen pyje publike, që janë nën administrim të bashkive, përgjegjës janë inspektorët që janë pranë këtyre strukturave. Ndërkohë, ju e dini që të gjitha kundërvajtjet, sidomos ato penale në mjedis, janë të parashikuara edhe në Kodin Penal dhe janë quajtur krim mjedisor. Prandaj, i është kushtuar shumë rëndësi edhe nga vetë Kryeministri, edhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për të rritur bashkëpunimin me strukturat, me qëllim që të kemi zbatueshmëri të ligjit në uljen e rasteve të kundërvajtjeve qoftë penale apo administrative në territore.

Pra, është e përcaktuar qartë struktura në varësi të territoreve që janë në administrim. Në rastin e territoreve të zonave të mbrojtura janë administratat rajonale me inspektorët e tyre. Në rastet e pyjeve bashkiake ose publike në varësi të strukturave të regjistruara për administrim janë inspektorët pranë bashkive, sepse u kanë kaluar atyre tashmë disa territore të konsiderueshme të pyjeve dhe kullotave. Ndërsa, në rast kur vihet re që ka kundërvajtje penale, është Policia e Shtetit ajo që reagon. Besoj se isha e qartë me këtë shpjegim që lidhet me të 3 autoritetet përgjegjëse për zbatueshmërinë e kontrollit të ligjit.

Është shumë e rëndësishme të përmendim se rezultatet e moratoriumit kanë qenë të dukshme, janë të lidhura edhe me materialet që ju keni, qoftë nga të gjitha studimet që ne kemi mundur të bëjmë, nga vrojtimit që janë bërë, qoftë nga censusi i shpendëve, qoftë nga

vrojtimet në terren që janë bërë nga inspektorët tanë, qoftë nga të dhënat dhe raportet që janë vënë në dispozicion nga studiues, nga shoqatat mjedisore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Prandaj ju dhashë një sërë shifrash, nuk u zgjata në detaje, duke marrë në konsideratë faktin që jemi në Komisionin e Ekonomisë, për të dhënë specifikime lidhur me rritjen e numrit të individëve, me studimet që janë bërë apo edhe të dhënat që kemi nga kamerat kurth. Në një pjesë të mirë të territorit janë vendosur kamera, të cilat bëjnë edhe monitorimin, edhe shikojnë rastet kur ka kundërvajtje mjedisore. Prandaj, në material keni tabelat që reflektojnë rritjen e theksuar të numrit të individëve, qoftë të shpendëve të egër, qoftë edhe të individëve të faunës së egër.

Po ashtu, keni një tabelë të detajuar që ju është vënë në dispozicion, e cila lidhet me rritjen e numrit të arinjve, të maceve të egra, të rrëqebujve. Pra, është një tabelë që ju tashmë e keni dhe nga të dhënat rezulton se vetëm në vitin 2017 janë parë, janë vrojtuar në terren nga inspektorët 105 arinj, ndërsa në vitin 2019 janë identifikuar 429 individë. Pra, kemi një rritje të konsiderueshme dhe kjo ka ardhur pikërisht si rrjedhojë e zbatueshmërisë së moratoriumit për 7 vjet.

Përveç krijimit të qetësisë së nevojshme për shpendët qofshin ata edhe shtegtarë, edhe numri i individëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, qoftë këto në territorin e zonave të mbrojtura ose jo, numri i tyre është rritur ndjeshëm. Si pasojë e kësaj situatë ka ardhur edhe shtimi i numrit të vizitorëve, numrit të turistëve që janë jo vetëm vrojtues të botës së egër, por janë edhe fotografë të botës së egër, edhe dashamirës së natyrës, sepse duhet të theksojmë që sidomos pas pandemisë njerëzit filluan të rikthehen te natyra dhe këtu vihet re edhe numri i shtuar i turistëve. Siç e theksova edhe më parë numri i tyre është rreth 4 milionë, vetëm në territoret e parqeve dhe zonave të mbrojtura, ku ne kemi shifra nëpërmjet numrit të biletave, ku shumica prej tyre është paraparë që shpenzojnë rreth 120 euro në ditë, duke pasur parasysh qëndrimet e tyre në këto zona. Pra, po sqaroj se m'u bë një pyetje që lidhet me koston. Kështu, përlllogaritet që secili nga këta vizitorë shpenzon rreth 120 euro gjatë qëndrimit mesatarisht për akomodim, për ushqim dhe për vizita në zonat e mbrojtura. Pra, kemi një total të ardhurash për bizneset prej rreth 62 miliardë e 290 mijë lekë dhe sigurisht duke pasur parasysh këto lloj trendi, parashikohet që për vitin 2025 këto shifra të arrijnë deri në 42 miliardë e 555 milionë e 160 mijë lekë. Më lejoni të them se vetëm nga shitja e biletave në zonat e mbrojtura në vitin 2021 të ardhurat kanë qenë 6 milionë e 783 mijë lekë. Pra, duke pasur parasysh funksionimin që kemi në disa nga parqet me biletarinë elektronike, por edhe në raste kur ajo mungon, përmirësimi i infrastrukturës në këto zona,

krijimi i qetësisë, rritja e numrit të individëve, rritja e numrit të shpendëve, ndihmojnë në shtimin e turistëve.

Për shembull, u theksua këtu që në Shkodër është vënë re që nuk është aq i dukshëm efekti i moratoriumit, ndërkohë një nga kolegët tuaj të nderuar, pranoi se sidomos në zonën e Shirokës dhe në zonën liqenore dhe ligatinore atje, ka një rritje të konsiderueshme të shpendëve, gjë që ka sjellë edhe rritjen e numrit të turistëve.

Lidhur për aktivitetin e peshkimit, dua të them se peshkimi i paligjshëm është i ndaluar dhe Policia e Shtetit, e cila në bashkëpunim me strukturat e tjera duhet të jetë shumë prezentë dhe të reagojë kur ky aktivitet ndodh në mënyrë të paligjshme. Peshkimi nuk është kompetencë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, por është nën varësinë të Ministrisë së Bujqësisë, por që patjetër është një aktivitet tjetër, mbi të cilin duhet të shtohet akoma më shumë kontroll për zbatueshmërinë e ligjit dhe bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit. Prandaj, gjatë gjithë kohës është vënë fokusi te takimet kombëtare, te presioni pozitiv, edhe me institucionet e vetëqeverisjes vendore, sepse është shumë e rëndësishme, që ata të fillojnë të mendojnë dhe ta shikojnë mjedisin si një nga sektorët me prioritet dhe me rëndësi, se vetëm në këtë mënyrë, në qoftë se kanë strukturat e nevojshme për menaxhimin dhe kontrollin e territoreve që ka në administrim, do të mund të kemi një përmirësim të situatës ku ndodhemi.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Të mbaroj dhe pastaj nëse keni pyetje tjetër ma thoni.

Lidhur me konsultimin publik, ky është një nga ato projektligje, që realisht i ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publik. Një instrumente shumë i mirë për këto konsultime është Këshilli Kombëtar i Faunës, i cili ka në përbërje, përveç ekspertëve të ministrisë, edhe ekspertë nga agjencitë vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të shoqatave mjedisore, ka edhe përfaqësues të federatave të gjuetarëve. Patjetër, ne u kemi krijuar mundësinë atyre, jo vetëm në këto dy- tre takime, por sa herë ata e kanë parë të nevojshme dhe kur na kanë kërkuar takime, ne kemi qenë të gatshëm për t'i dëgjuar me vëmendje. Sigurisht, janë një grup interesi i konsiderueshëm, i cili impaktohet nga ky projektligj. Megjithatë ashtu siç e thashë, duke marrë në konsideratë një sërë efektesh pozitive që ka pasur dhe nevojën për të krijuar një qëndrueshmëri lidhur me faunën e egër, ministria e ka parë të arsyeshme të me zgjasë për një 5-vjeçar tjetër të moratoriumit.

Lidhur me gjurmueshmërinë e armëve të gjahut, ju, kryetar, na bëtë një pyetje dhe na dhatë disa sugjerime, kështu që në dijeninë time ka pasur një diskutim para disa kohësh për këtë gjë. Gjithashtu, strukturat e Policisë së Shtetit janë të interesuara për ta çuar këtë

program përpara. Është shumë e rëndësishme, ashtu siç e thoni ju, sepse është një nga mënyrat që në momentin, kur të mbarojë zbatueshmëria e moratoriumit, t'i kemi strukturat e gatshme dhe të fuqizuara, për të krijuar mundësinë e zbatueshmërisë së ligjit. Di që kjo është një punë në proces, por nuk di në çfarë faze është aktualisht.

Për sa u përket pyetjeve që lidhen me sekuestrimin e armëve të gjahut, në fakt, në vitin 2014, në vitet e para kur filloi moratoriumi i gjuetisë, janë sekuestruar 630 armë.

Patjetër që në çdo lloj investimi të rëndësishëm, investimi strategjik, konsultimi me publikun është shumë i rëndësishëm. Në dijeninë time, në çdolloj procesi përpara se të vendoset për të investuar dhe për të ndërtuar, për të marrë masa për të përmirësuar infrastrukturën, pjesa e konsultimit me publikun ka ndodhur, sepse ky është një element i rëndësishëm që ne përpiqemi gjithmonë mos ta anashkalojmë. Edhe për sa i takon investimit që lidhet me aeroportin e Vlorës, edhe pse nuk është objekt i diskutimit të sotëm, në dijeninë time janë bërë disa dëgjesa me komunitetin, me grupet dhe me shoqatat mjedisore atje. Nëse ju jeni të interesuar, besoj se nga ministria mund t'u vihen në dispozicion të gjitha shënimet që janë mbajtur gjatë këtyre takimeve konsultative.

(Debat pa mikrofon në sallë.)

Patjetër, nëse ju do të doni një informacion më të detajuar, ne mund t'ua vëmë në dispozicion, por çdolloj procesi i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis.

U bë një pyetje në lidhje me projektligjin që Federata e Gjuetarëve e kishte sjellë në Kuvend, dhe për këtë do ia kaloj fjalën koleges sime Klodiana, duke qenë se ka një eksperiencë më të gjatë në këtë fushë dhe e ka ndjekur këtë proces nga fillimi.

Faleminderit!

Klodiana Marika - Faleminderit, zëvendësministre!

Faktikisht, unë kam qenë prezente në të tria moratoriumet dhe për saktësim, në radhë të parë, lidhur me petition me 21 mijë firma dhe me sekuestrimin e armëve, dihet që ka vetëm një petitionin të bërë nga njëra prej shoqatave, pasi nuk e kanë bërë të dyja shoqatat. Pra, në terren kemi dy shoqata, të cilat janë antagoniste me njëra-tjetrën dhe nëse do i referohemi projektligjit që ka dorëzuar Federata e Gjuetarëve, ajo kërkon monopol të ushtrimit të gjuetisë, ndërkohë në projektligjin që ka bërë Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit ia kalon këtë kompetencë njërive të vetëqeverisjes qendrore në kuadër të funksioneve decentralizuese.

Për sa u përket zonave të mbrojtura, si me moratorium, edhe pa memoratorium, gjuetia është kudo e ndaluar.

Gjithashtu, po ju bëj me dije se subjekti i këtij komisioni, që ka subjekt ekonominë, së pari, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka shumë rëndësi që projektligji nuk ka kosto shtesë për t'u zbatuar, për buxhetin e shtetit, por ka përfitime, nëse i referohemi dokumentit të ndikimit të rezultateve, i cili është shumë i elaboruar dhe i specifikuar, po ashtu janë përlllogaritur njëkohësisht edhe humbjet që pësojnë shoqatat e gjuetarëve, nëse do t'u referohemi atyre, por edhe përfitimet që vijnë nga buxheti i shtetit, referuar numrave në rritje të vizitorëve të huaj. Nuk e kam fjalën këtu për numrin total të vizitorëve të huaj në Shqipëri, por vetëm për ata që vizitojnë zonat e mbrojtura. Ne kemi marrë koston më të ulët të mundshme, që mund të harxhojë një turist i natyrës dhe, nëse i referohemi analizës së kostove dhe përfitimeve, ky drejtim përfitimi është në favor të buxhetit të shtetit.

Ju thoni se numri i konsultimeve publike është i vogël.

Në të vërtetë në konsultime publike ka grupe të ndryshme interesi, çka nënkupton se për çdo projektligj apo vendim të Këshillit të Ministrave ftohen të marrin pjesë grupet e interesit që impaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose në një mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por preken në interesat e tyre.

Unë, në faqen *online* të administratorit të konsultimit publik nuk kam parë numër më të madh se 1351 raste vizitorësh, që nuk kanë bërë komente. Ndërkohë, për këtë projektligj janë bërë 4-5 diskutime me federatat, dhe qëndrimet janë të dykahshme: qëndrime konservacioniste, që vijnë nga shoqatat e mbrojtjes së mjedisit dhe qëndrimin për të hapur gjuetinë, për ta pezulluar memoratoriumin, që vjen vetëm nga një federatë, jo nga të dyja federatat.

Mendoj se në aspektin ekonomik projektligji është përfitues për mjedisin, pasi krijon qetësi dhe njëkohësisht u përshtatet detyrimeve të konventave ndërkombëtare dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për mbrojtjen e faunës së egër dhe të habitateve.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Dakord.

Përfunduat me përgjigjet?

Fjalën e ka kërkuar zoti Sinaj.

Më pas do të marrë fjalën zonja Resuli.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Nuk e dëgjova përgjigjen. A ka kosto në buxhetin e shtetit?

Nuk ka kosto.

Në dokumentet që na kanë ardhur kemi një tabelë për kostot dhe përfitimet, në të cilën shkruhet: kosto për punën kontrolluese të inspektorëve të strukturave përkatëse në terren. Këtë kosto e keni sot, apo do të rritet pa moratoriumit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, do të vazhdoni sërish me të njëjtët inspektorë?

Si do ta përmirësoni? Thoni se do të bëni moratorium për të përmirësuar punën në të ardhmen, por nëse keni të njëjtët inspektorë dhe të njëjtat kosto, si do ta realizoni këtë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre, se nuk kam nevojë të përgjigjeni.

Unë jam deputet i maxhorancës, por njëkohësisht e kam ushtruar sportin e gjuetisë dhe mendoj se e di më mirë se shumë prej jush se çfarë ndodh në realitet.

Të thuash sot se je gjuetar, je kundër me ambientalistët, por është sport, ekziston në të gjithë botën, jo vetëm këtu.

Problemet në gjueti, që kanë qenë probleme në praktikë, janë zbatimi i rregullave, zbatimi i ligjit. Unë kam, të paktën, 6 vjet deputet dhe po pres prej 5 vjetësh të dalë ligji. Pse nuk e nxirrni ligjin e gjuetisë? Pra, të dalë një ligj i saktë gjuetie dhe të kërkohet zbatimi i tij.

Në Shqipëri faunën e dëmtojnë gjuetarët e parregullt, që gjuajnë natën. Natën nuk lejohet të gjuash shpendët apo kafshët, është e ndaluar me ligj, është e ndaluar me Zot, me Kuran dhe me Bibël. Ne kemi gjuetarë që gjuajnë natën dhe jashtë sezonit të gjuetisë, të cilët duhen ndaluar. Gjuetia ka rregullat e veta, nuk gjuhet kur është sezoni i shumimit. Nëse do ta kishim të ndaluar gjuetinë natën dhe gjuetinë jashtë sezonit, nëse do të kishim një ligj, shumë njerëz do të kishin mundësi ta ushtronin këtë sport. Në Kosovë ka rregulla strikte dhe ata nuk i thyejnë, por nuk kanë moratorium.

Mendoj se nuk mund të shkojmë moratorium pas moratoriumi dhe të lejojmë gjuetarë jo të rregullt. Gjuetarët e rregullt, që zbatojnë ligjin, rrinë në shtëpi, po kthehen në ambientalistë, po u ikën mosha dhe ndjesia për të gjuajtur, dhe do të ngelen vetëm ata që gjuajnë jashtë rregullave. Unë jam kundër.

Jam i mendimit për shtyrjen e një afati 1-vjeçar, siç ka propozuar shoqata, ku të merren masa për të vendosur ligjin, por jo të vazhdojmë me afate 5-vjeçare. Bëhen moratoriume dhe sërish e pranojmë vetë, se në relacion është e shkruar që ka pasur gjueti të parregullt, ka pasur thyerje rregullash, sepse nuk arrijmë ta bëjmë, dhe sërish vijnë duke na thënë se do ta mbulojnë pa kosto shtesë. Vendi ynë është i bekuar, është vend gjuetie. Në romane dhe në libra historike mund të lexosh që në Shqipëri dhe në zonën e Vlorës kanë

ardhur gjuetarë nga Anglia dhe nga vende të ndryshme të botës. Ne duhet ta duam florën dhe faunën tonë, por duhet ta ruajmë nga ata që duhet ruajtur, jo nga ata që zbatojnë ligjin.

I dashur koleg,

Jemi miq dhe shokë bashkë, por dëgjova kolegen tuaj që foli dje në parlament për aeroportin e Vlorës. Dua të them se aeroporti nuk ka qenë zonë e mbrojtur, ka qenë zonë ushtarake. Nga zonë ushtarake ka kaluar në zonë ushtarake në aeroport. Të dy ne, si deputet të Vlorës, pavarësisht se unë jam i majtë dhe ti i djathtë, mendoj se jemi dakord, apo ju jeni kundër aeroportit të Vlorës, si parti politike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni kundër aeroportit të Vlorës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjova të flisnit edhe dje në parlament, ndaj më bëri përshtypje.

Eduard Shalsi – Zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Me respektin më të madh për drejtoreshën, kosto në buxhetin e shtetit nuk do të quajmë vetëm kur të kërkojmë 50 inspektorë shtesë. Në këtë rast nuk keni kërkuar, nuk ka kosto shtesë, por kosto në buxhetin e shtetit është dështimi i inspektorëve ekzistues për të zbatuar ligjin për gjuetinë dhe moratoriumin në mënyrë të tillë, që vini dhe kërkon shtesë. Ne konsiderojmë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dështimin, në një farë mënyrë, të zbatimit të moratoriumit dhe të ligjit për gjuetinë.

Eduard Shalsi – Dakord

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në mbyllje, ju lutem!

Almira Xhembulla – Kam vetëm një koment të fundit.

Nuk e di si është lexuar në relacion, sepse ndoshta mund të kishim qenë edhe më shterues gjatë fjalës sonë, por e ritheksoj se ne vlerësojmë që moratoriumet e deritanishme kanë pasur efekte pozitive. Sigurisht, ka pasur raste përjashtimore. Ne nuk kemi arritur të ndalojmë të gjithë aktivitetin e gjuetisë së paligjshme, por e pranojmë që deri tani zhvillimi, rritja dhe përmirësimi i faunës së egër, krijimi i qetësisë dhe përmirësimi i habitateve ku jeton fauna e egër, të gjitha të dhënat janë shumë progresive, shumë domethënëse dhe janë baza për të cilën ne kemi vendosur ta zgjasim edhe për 5 vjet të tjera, sepse mendojmë se efekti ka qenë pozitiv, por nuk jemi në nivelin ku duam, edhe duke u krahasuar me vendet e rajonit, si: Kosova, Maqedonia, Greqia apo me territore të tjera për parqet kombëtare. Sigurisht, nuk jemi në situatën që do të donim të ishim për sa i takon përmirësimin të konsiderueshëm të faunës dhe të individëve të jetës së egër.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Shumë shkurt, ju lutem!

Pranvera Resulaj – Jemi në një mendje, nuk po diskutojmë në asnjë moment përkushtimin, angazhimin dhe domosdoshmërinë e ruajtjes së mjedisit. Për këtë nuk dua të kemi asnjë dilemë dhe dyshim. Keni mirëkuptimin dhe mbështetjen maksimale, por nuk mund të bie dakord që në relacion të shkruhet se ka pasur pamundësi nga ana e inspektorëve të inspektorateve të ruajtjes së mjedisit për të pasur më tepër rezultat në këtë moratorium. Ky është i gjithë diskutimi im për pamundësinë. Pra, ne nuk mund të lejojmë inefficiencën e inspektorëve të na pengojë për të pasur rezultate më të mira. Në asnjë moment nuk jam për të mos e trajtuar me rëndësi shumë të madhe këtë moratorium për sa i përket ruajtjes së mjedisit.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Zoti kryetar, një moment, ju lutem!

Për sa u takon institucioneve inspektuese dhe kontrolluese për këtë projektligj, ka pasur një ndryshim të këtyre strukturave në vite me qëllim përmirësimin e eficiencës dhe rritjen e zbatueshmërisë dhe kontrollit të territorit nga ana e tyre qoftë të inspektorateve, qoftë edhe të marrjes së përgjegjësisë nga Policia e Shtetit, sepse krimet mjedisore nuk kanë qenë më parë kompetencë e Policisë së Shtetit; apo për krijimin e strukturave në nivel bashkie, pasi ka ardhur si rrjedhojë, pas reformës territoriale, që strukturat në bashki morën në administrim një territor të konsiderueshëm të pyjeve dhe kullotave. Pra, nuk mund të flasim për të njëjtat struktura inspektuese dhe kontrolluese nga viti 2014 deri më sot. Pikërisht për këto arsye, për të përmirësuar performancën dhe për të rritur eficiencën e punës së tyre ka pasur ndryshime të vazhdueshme, qoftë për sa i takon rolit të Policisë së Shtetit për çdo kundërvajtje penale në mjedis, apo me strukturat që janë në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ose të bashkive. Pra, ka pasur një vullnet të vazhdueshëm për të riorganizuar dhe përmirësuar eficiencën e tyre.

Eduard Shalsi – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Zoti kryetar, unë në fjalën time në cilësinë e relatores nuk i thashë treguesit, por nëse do t'i referohemi relacionit, i cili është në dispozicion të të gjithë anëtarëve të komisionit, nga viti 2014 deri në vitin 2020 statistikat flasin se është bërë një punë shumë e mirë krahasuar me gjetjet që janë reflektuar nga viti 2014 për inspektimet, për gjobat, për procedimet nga institucionet përgjegjëse, çka tregon se ligji dhe moratoriumi janë respektuar

nga institucionet përgjegjëse përderisa kemi tregues. Patjetër që duhet shumë punë në vazhdimësi, ndaj vijmë sot me një projektligj të ri për të zgjatur afatin me 5 vjet të tjerë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – E mbyllim debatin dhe diskutimet.

Besoje se përfaqësuesit e ministrisë mbajtën shënime.

Para se të kalojmë në votim, ne do ta miratojmë këtë moratorium.

Nga ana tjetër, do të kërkojmë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta shikojmë në rezultat.

Nga ana tjetër, do të kërkojmë dy gjëra:

E para, nuk duhet të rreshtim përpjekjet për një ligj të ri për gjuetinë.

E dyta, do t'ju vendos në dispozicion konceptin e prezantuar në vitet 2014-2015 për menaxhimin, që nga armët e gjuetisë deri te lejet dhe gjurmueshmëria e gjuetarëve. Pasuria e gjuetisë është kombëtare dhe nëse do të shfrytëzohej si duhej, mbaj mend analizat për anëtarësitë në atë kohë, Vullnet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Pra, debati nuk përfundon te miratimi i moratoriumit, por herë pas here do të thërrasim përfaqësuesit e ministrisë për të parë sistemin dhe ligjin, sepse duam të përgatitemi për të nesërmen e ditës kur moratoriumi nuk do të ekzistojë.

Përpos të gjitha arritjeve me punën parandaluese, efektet e moratoriumit janë shumë të dukshme kudo në Shqipëri, por kjo nuk na pengon të konstatojmë që pjesa delikate e inspektorateve, nëse doni edhe atë të ndërtimit, i keni parë edhe deklaratat e pakënaqura të Kryeministrit me kontrollin e territorit, që është shumë, shumë e shumë më i mirë nga çfarë ishte, por larg asaj që duhet të jetë, ndaj përmirësimi i inspektorateve është një tjetër detyrë që mbetet për t'u bërë.

Kalojmë te votimi i projektligjit.

Ndërkohë, kemi rakorduar se nuk ka ndryshime.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndryshime për nenet? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?.

Miratohet.

Je abstenim për të gjitha nenet, apo për një nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 3.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?.

Miratohet.

Neni 5.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 1 abstenim

Miratohet.

Do të shihemi në mbledhjen e ardhshme.

Antoneta Dhima – Ditën e djeshme në seancën plenare ne diskutuam raportin e veprimtarisë së INSTAT-it për vitin 2021 dhe njëkohësisht miratuam rezolutën e veprimtarisë së këtij institucioni për vitin 2022. Në fjalën e saj drejtoresha e INSTAT-it theksoi se në tetor të këtij viti do të fillojë censusi i popullsisë dhe banesave. Do të doja që drejtuesja e këtij

institucioni të ftohet në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave për të na raportuar masat përgatitore, për punën e bërë, që ky proces të realizohet me sukses.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Dakord.

Besoj se shërbimet e Kuvendit e kanë mbajtur shënim këtë kërkesë, që të programojmë një takim në agjendë.

Kam një kërkesë: ditën e enjte të mos bëjmë mbledhje.

Nesër është pushim.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti